



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2018

**PER PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË NDËRTESAVE QË
PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMI I PIKËS SË AKSESIT PËR
INFRASTRUKTURËN E RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 20, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë,

V E N D O S I:

1. Të përcaktoje kategoritë e ndërtesave që përjashtohen nga detyrimi për të pasur pikë akses në godinë për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen autoritetet planifikuese qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**KATEGORITË E NDËRTESAVE QË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMI
PËR PIKËN E AKSESIT PËR INFRASTRUKTURËN E RRJETEVE TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE**

Kategoritë e ndërtesave që përjashtohen nga detyrimi për të pasur pikë aksesit në godinë për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike, janë:

1. Ndërtesat në përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe/ose forcave ushtarake, si dhe godinat në përdorim për qëllime të sigurisë kombëtare;
2. Ndërtesat e reja që përfshihen në listën e monumenteve kulturore apo që ndodhen në qendra, zona dhe parqet arkeologjike, në zona të mbrojtura në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, kur ndërtimi i pikës së aksesit në godinë mund të ndryshojë në mënyrë të papranueshme karakterin ose pamjen e tyre;
3. Ndërtesa në zona të izoluarra e të largëta, ku perspektiva për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, nuk e justifikon pajisjen e godinës me infrastrukturë fizike të gatshme për komunikime elektronike me shpejtësi të lartë ose me një pikë aksesit.
4. Ndërtesa që shërbejnë si hangarë, sera bujqësore, garazhe, magazina apo godina të vogla të shërbimeve që nuk sigurojnë shërbime të fjetjes;
5. Përjashtimi për ndërtesat e përmendura në pikën 2, do të aplikohet dhe në rastet e miratimit të lejeve për punime të rikonstruksioneve, riparimeve, restaurimeve në një godinë biznesi apo banimi.
6. Përjashtimi do të aplikohet dhe në rastet e miratimit të lejeve për punime të rikonstruksioneve, riparimeve, restaurimeve në një godinë biznesi apo banimi, kur investimi për përmbushjen e detyrimit për pikën e aksesit në godinë nuk është proporcional me punimet e rinovimit dhe përfitimin e individit apo të bashkëpronarëve të ndërtesës; Në këtë rast, aplikuesi për leje duhet të vërtetojë pranë autoritetit planifikues miratues, që kostot e parashikuara për pikën e aksesit janë të paarsyeshme dhe disproporcionale, në raport me punimet që kërkohen të realizohen. Aplikuesi duhet të paraqesë mjetet alternative që disponohen për sigurimin e aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.
7. Shtëpitë e pushimit, verore ose dimërore, të cilat nuk përdoren si qendra rezidenciale për banim.